



USHTRIA



Viti i 78-të i botimit Nr. 25 (827930)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 27 qershor 2025

Kryeministri Rama dhe ministri Vengu në qendër të strategjisë së re të NATO-s: Shqipëria afirmon leadershipin në sigurinë transatlantike, Tiranë - Samiti 2027



» faqe 3



MESAZH URIMI I SHSHPFA, GJENERALLEJTËNANT ARBEN KINGJI ME RASTIN E 18-VJETORIT TË QENDRËS SË PERSONEL REKRUTIMIT

Në këtë 18-vjetor të krijimit të QPR-së, kam kënaqësinë të vlerësoj arritjet dhe rolin që kjo strukturë ka në rekrutimin e personelit për kompletim me kapacitete njerëzore të Forcave të Armatosura. Qendra e Personel Rekrutimit është porta hyrëse e ushtrisë sonë, themeli mbi të cilin ndërtohet fuqia...



» faqe 2



MINISTRI I MBROJTJES VIZITON REGJIMENTIN E KËMBËSORISË SË VERIUT NË VAUN E DEJËS: INVESTIME DHE MUNDËSI TË REJA PËR USHTARAKËT E RINJ

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, zhvilloi një vizitë zyrtare në Regjimentin e Këmbësorisë së Veriut, i shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, dhe komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia. Gjatë takimit...



» faqe 2



MEDALJE ARI PËR SHQIPËRINË NË KAMPIONATIN BOTËROR USHTARAK TË ARTEVE MARCIALE, GJERMANI 2025

Kolonel Chermen Valiev bën histori për FA dhe Shqipërinë. Në një arritje të jashtëzakonshme për sportin shqiptar dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, kolonel Chermen Valiev ka fituar medaljen e artë në kategorinë olimpike 74 kg në Kampionatin Botëror Ushtarak të Arteve Marciale – CISM...



» faqe 5

Në këtë 18-vjetor të krijimit të QPR-së, kam kënaqësinë të vlerësoj arritjet dhe rolin që kjo strukturë ka në rekrutimin e personelit për kompletim me kapacitete njerëzore të Forcave të Armatosura.

Qendra e Personel Rekrutimit është porta hyrëse e ushtrisë sonë, themeli mbi të cilin ndërtohet fuqia njerëzore. Misioni juaj është thelbësor për gjallërimin dhe vazhdimësinë e strukturave tona. Rezultatet e viteve të fundit flasin vetë: objektivat e rekrutimit jo vetëm janë realizuar, por shpesh janë tejkaluar, falë përkushtimit tuaj në terren, komunikimit me qytetarët, bashkëpunimit institucional dhe menaxhimit me efektivitet të burimeve njerëzore. Këto arritje janë edhe falë mbështetjes së qeverisë shqiptare dhe Ministrisë të Mbrojtjes në përmirësimin e trajtimit financiar e social të ushtarakëve, e cila ka ndikuar në rritjen e interesit të brezave të rinj për t'u bashkuar me Forcat e Armatosura. Megjithatë, sfidat vijnë. Përveç kërcënimeve të vazhdueshme në mjedisin gjeopolitik dhe atë të sigurisë, realizimi në vijimësi i planit të rekrutimeve, jo vetëm me rekrutë të rinj, është sot më i rëndësishëm se kurrë. Rekrutimi sipas

Mesazh urimi i SHSHPFA, gjenerallejtënant Arben Kingji me rastin e 18-vjetorit të Qendrës së Personel Rekrutimit



planit i forcave rezerviste kërkon përkushtim të veçantë, planifikim të kujdesshëm dhe komunikim të vazhdueshëm me shtetasit shqiptarë që do të integrohen me forcat aktive.

Po ashtu, puna për rekrutim duhet të jetë gjatë gjithë vitit, përtej fushatave sensibilizuese dhe të përqendrohet në realizimin e planit në të gjitha seksionet përkatëse të qarqeve.

Në këtë ditë të rëndësishme, ju falënderoj për profesionalizmin dhe përkushtimin tuaj!

Shtabi i Përgjithshëm i FA-së do të vijojë t'ju mbështesë në çdo hap të rrugëtimit tuaj.

Ju inkurajoj të vazhdoni me përkushtim dhe ndjenjë përgjegjësie në realizimin e kërkesave të FA-së për kompletim me ushtarakë aktivë, rezervistë dhe personel civil.

Gëzuar 18-vjetorin!

Suksese në familjet tuaja dhe në kryerjen e detyrave të misionit!

Faleminderit për shërbimin tuaj!

Ministri i Mbrojtjes viziton Regjimentin e Këmbësorisë së Veriut në Vaun e Dejës: Investime dhe mundësi të reja për ushtarakët e rinj

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, zhvilloi një vizitë zyrtare në Regjimentin e Këmbësorisë së Veriut, i shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, dhe komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia.

Gjatë takimit me rekrutët e rinj, ministri Vengu vuri theksin mbi përkushtimin e Ministrisë së Mbrojtjes për përmirësimin e kushteve të shërbimit dhe mbështetjen e të rinjve që zgjedhin rrugën e karrierës ushtarake.

“Shumë shpejt, ju do të keni në dispozicion veshje dhe pajisje të reja, ndërsa projektet për ndërtimin e godinave të akomodimit janë në zhvillim”, - u shpreh ministri Vengu. Ai shtoi gjithashtu se do të krijohen më shumë mundësi për trajnim dhe arsimim profesional për të gjithë ata që ndjekin karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura.

Gjatë periudhës 2023–2025, në këtë regjiment janë realizuar mbi 126 milionë lekë investime, të cilat kanë përfshirë përmirësimin e infrastrukturës dhe kushteve të punës. Aktualisht është në proces ndërtimi një objekt i ri me vlerë rreth 157 milionë lekë, ndërsa totali i investimeve të parashikuara deri në vitin 2026 pritet të arrijë në mbi 284 milionë lekë.

Këto investime konsiderohen një hap konkret drejt modernizimit dhe forcimit të kapaciteteve të Regjimentit të Këmbësorisë së Veriut, në përputhje me objektivat strategjike të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.



Ekipet EOD në Batalionin e Xhenios vlerësojnë municionet e gjetura në bashkinë Durrës dhe Klos

Efektivët e Kompanisë EOD në Batalionin e Xhenios përfunduan operacionet për kontrollin, vlerësimin, asgjësimin dhe largimin e municioneve të rrezikshme në bashkitë Durrës dhe Klos. Ekipi EOD u angazhua në operacion në mbështetje të autoriteteve civile në bashkinë Klos, duke bërë kontrollin dhe verifikimin e municionit tip granatë dore të cilën e vlerësuan të lëvizshme. Një tjetër operacion është realizuar nga specialistët EOD, të cilët me pajisje speciale, aparat metalkërkues në thellësi kanë bërë kontrollin e sipërfaqes detare pranë portit të Durrësit, ku kanë identifikuar municione luftarake, predha mortaje. Me profesionalizëm dhe duke zbatuar të gjitha rregullat e parashikuara në manualët përkatëse EOD, kryeoperatori konstatoi se municionet ishin të prekshme, duke bërë më pas transportimin e tyre në depot e Batalionit të Xhenios. Efektivët e Kompanisë EOD dëshmojnë profesionalizëm, kurajë dhe përgjegjësi për realizimin e detyrave të vështira, duke garantuar siguri për komunitetin.



Kryeministri Rama dhe ministri Vengu në qendër të strategjisë së re të NATO-s: Shqipëria afirmon leadershipin në sigurinë transatlantike, Tiranë - Samiti 2027

Në platformën strategjike të Samitit të NATO-s, të mbajtur më 24-25 qershor 2025 në Hagë, delegacioni i Shqipërisë, i udhëhequr nga kryeministri Edi Rama, ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu, ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme Igli Hasani, shefi i Shtabit të Përgjithshëm Arben Kingji dhe përfaqësues të inteligjencës, afirmoi një angazhim të qartë ndaj mbrojtjes kolektive dhe sigurisë transatlantike. Vendimet për investimin strategjik në Portin e Ri të Durrësit dhe organizimin e Samitit 2027 në Tiranë ishin ndër pikat më të spikatura të përfaqësimit shqiptar.

Takimi Rama-Rutte: Një aks i ri strategjik

Në një moment kulmor të Samitit, kryeministri Edi Rama zhvilloi një takim bilateral me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Mark Rutte. Diskutimet u përqendruan në sigurinë në Ballkanin Perëndimor, si dhe projektin ambicioz për ndërtimin e një terminali ushtarak në Portin e Ri të Durrësit, ku NATO pritet të ketë rol praktik dhe operacional.

Roli i ministrit Pirro Vengu në forumet ushtarake të NATO-s

Ministri Vengu ishte pjesë aktive e sesioneve të Ministrave të Mbrojtjes, duke përforcuar angazhimin e Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të mbrojtjes dhe mbështetjen e industrisë ushtarake. Nga punimet në Bruksel deri te diskutimet strategjike në Hagë, ai konfirmoi qasjen proaktive të vendit në planifikimin e dekadës së ardhshme të Aleancës.

Deklaratat përfundimtare të samitit përfshinë: Dedikimin e 5% të GDP-së për mbrojtje deri në 2035; Mbështetje të fuqishme për Ukrainën; Garancinë e fortë të nenit 5 për mbrojtje kolektive; Konsolidimin e rrjeteve të infrastrukturës kritike dhe kapaciteteve inovative të mbrojtjes.

Shqipëria, 'nikoqire' e Samitit të NATO-s 2027

Një moment historik u shënua me vendimin unanim të Aleatëve për të zhvilluar Samitin e NATO-s të vitit 2027 në Tiranë. Kjo përbën një vlerësim për tranzicionin euro-atlantik të Shqipërisë dhe aftësinë e saj



organizative, duke vendosur vendin në epiqendër të vëmendjes ndërkombëtare. Samiti i Hagës shërbeu si një pikë kthese për rolin e Shqipërisë në Aleancën Veri-Atlantike. Me dy figura

udhëheqëse, kryeministrin Rama dhe Ministrin Vengu, Shqipëria demonstroi vizion strategjik, përfshirje aktive dhe besueshmëri si një partner i sigurisë kolektive. Investimi në Porto Romano



dhe konfirmimi i Tiranës si qytet pritës për Samitin e ardhshëm janë dëshmi të këtij kapitulli të ri në politikën e jashtme dhe të mbrojtjes së vendit.





Gjenerallejtënant Arben Kingji priti në takim Drejtorin e Komponentit ajror të Gardave Kombëtare të SHBA-së, gjeneralmajor Duke Pirak

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjenerallejtënant Arben Kingji priti Drejtorin në detyrë të Komponentit ajror të Gardave Kombëtare të SHBA-së, gjeneralmajor Duke Pirak.

Gjenerallejtënant Kingji, pasi i uroi mirëseardhjen, vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm me Gardën Kombëtare të Nju-Xhersit, duke nënvizuar se ky bashkëpunim ka shërbyer në modernizimin e Forcave të Armatosura shqiptare në rritjen e ndërveprueshmërisë dhe gatishmërisë.

Më tej gjatë takimit, gjenerallejtënant Kingji vlerësoi në mënyrë të veçantë kontributin dhe mbështetjen e SHBA-ve në fushën e mbrojtjes, duke veçuar atë me Gardën e Nju-Xhersit, për rritjen dhe konsolidimin e kapaciteteve të Forcës Ajrore për mirëmbajtjen e helikopterëve dhe trajnimin e personelit fluturues dhe mbështetës të fluturimit.

Të dy bashkëbiseduesit gjatë takimit



diskutuan gjithashtu edhe mbi mundësinë e stërvitjeve të përbashkëta me Forcën Ajrore, në funksion të testimit të kapaciteteve dhe

infrastrukturës ushtarake.

Në mbyllje të takimit shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjenerallejtënant



Arben Kingji vlerësoi rolin e rëndësishëm të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në stabilitetin dhe sigurinë në rajon.

Gjeneral Brigade Ylli Pulaj priti në takim Atasheun Ushtarak të Turqisë

Komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë (KMS), gjeneral brigade Ylli Pulaj, priti në një takim zyrtar Atasheun Ushtarak të Turqisë rezident në Tiranë, kolonel Tolga Kip.

Gjatë takimit, gjeneral Pulaj i uroi mirëseardhjen kolonelit Kip dhe e njohu atë me misionin, detyrat, strukturën organizative dhe programet akademike që zhvillohen në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë përgjatë vitit. Biseda u fokusua në nxitjen e bashkëpunimit ndërinstitucional mes KMS-së dhe Universitetit Ndërkombëtar të Mbrojtjes së Turqisë, me theks të veçantë në zhvillimin e përbashkët të trajnimeve, seminareve dhe konferencave akademike,



si dhe në shkëmbimin e lektorëve dhe kursantëve.

Kolonel Kip, nga ana e tij, falënderoi gjeneralin Pulaj për mikpritjen dhe theksoi gatishmërinë e tij për të kontribuar në nismat e reja të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve arsimore ushtarake. Ai shprehu interesin për thellimin e marrëdhënieve përmes vizitave njohëse dhe projekteve të përbashkëta, duke nënvizuar rëndësinë e ndërveprimit profesional dhe akademik në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Ky takim shënon një hap të rëndësishëm drejt forcimit të lidhjeve arsimore ushtarake midis Shqipërisë dhe Turqisë.



Angazhimi i Forcës Ajrore në stërvitjet “Mburoja Ilire 50-25” e FT dhe “Durrësi SAREX 25” e FD

Forca Ajrore ka luajtur një rol thelbësor në dy stërvitjet e mëdha të FT dhe FD, përkatësisht “Mburoja Ilire 50-25” dhe “Durrësi SAREX 25”, të zhvilluar në rajonin e Pashalimanit dhe Durrësit. Forca Ajrore u angazhua me burime të specializuara dhe aftësi operacionale të avancuara, duke demonstruar profesionalizëm dhe gatishmëri të lartë në të dyja stërvitjet. Me përdorimin e helikopterit AS532 dhe ekuipazheve të trajnuara, Forca Ajrore realizoi: Mbështetje ajrore për operacionet e kërkim-shpëtimit dhe skenarët operativë, duke garantuar reagim të shpejtë dhe efektiv; Zbritje me litar (fast rope) dhe hedhjen e skuadrës palombare/zhytëse në det, duke treguar aftësi të larta të manovrimit dhe vendosjes së trupave në terrene specifike; Vëzhgim ajror dhe raportim të situatave emergjente, duke ndihmuar koordinimin e ekipeve midis strukturave dhe vendimmarrjen në kohë reale. Ky angazhim tregon edhe njëherë ndërveprueshmërinë dhe bashkëpunimin efektiv të Forcës Ajrore me forcat speciale të Forcës Tokësore, Forcën Detare dhe institucionet e tjera ndërinstitucionale. Realizimi i këtyre stërvitjeve synoi forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërstrukturor të FA-së në operacione komplekse; rritjen e aftësive taktike dhe operacionalitetit për reagim ndaj emergjencave detare dhe mjedisore; zbatimin e Planit Kombëtar për Operacionet e Kërkim-Shpëtimit dhe Planin Kombëtar të Emergjencave për Reagimin ndaj Ndotjeve Detare. Angazhimi në “Mburoja Ilire 50-25” dhe “Durrësi SAREX 25” pasqyroi edhe njëherë rëndësinë e rolit mbështetës të Forcës Ajrore në operacione që kërkojnë koordinim të avancuar dhe aftësi specifike. Me ekspertizën dhe profesionalizmin e saj, Forca Ajrore kontribuon në mënyrë të pandërprerë në forcimin e ndërveprimit mes strukturave dhe në përmbushjen e misionëve në shërbim të qytetarëve dhe mbrojtjes së mjedisit detar.

Gjeneralmajor Duke Pirak, drejtor në Detyrë i Forcave Ajrore të Gardës Kombëtare të SHBA, vizitoi Bazën Ajrore të Kuçovës

Gjeneralmajor Duke Pirak, drejtor në detyrë i Forcave Ajrore të Gardës Kombëtare të SHBA-së, zhvilloi një vizitë njëditore në Bazën Ajrore Kuçovë.

Gjenerali amerikan u prit nga zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Luan Sadiku, dhe komandanti i Bazës Ajrore të Kuçovës, kolonel Ardian Kuli. Gjatë vizitës ai dhe ekipi që kryesonte u shoqëruan nga zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneral brigade Altin Kurti.

Në fokus të diskutimeve ishin kapacitetet aktuale që ofron Baza Ajrore Kuçovë, projektet për modernizimin e bazës në sistemet e navigimit e të komunikimit ajror me qëllim krijimin e Kapaciteteve fillestare operacionale si një bazë taktike e NATO-s, në përputhje me standardet më të larta të aleancës.

Vizita konfirmoi rëndësinë e Kuçovës si një aset strategjik, jo vetëm për mbrojtjen kombëtare, por edhe për rolin e saj në rrjetin operativ të NATO-s. Ky bashkëpunim dëshmon përkushtimin e palëve për avancimin e kapaciteteve dhe garantimin e një mjedisi më të sigurt në rajon.



Medalje Ari për Shqipërinë në Kampionatin Botëror Ushtarak të Arteve Marciale, Gjermani 2025

Kolonel Chermen Valiev bën histori për FA dhe Shqipërinë

Në një arritje të jashtëzakonshme për sportin shqiptar dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, kolonel Chermen Valiev ka fituar medaljen e artë në kategorinë olimpikë 74 kg në Kampionatin Botëror Ushtarak të Arteve Marciale – CISM World Military Martial Arts Championship 2025, që po zhvillohet në Warendorf, Gjermani, nga data 22 deri më 29 qershor. Kjo është medalja e parë e artë në historinë 113-vjeçare të Forcave të Armatosura, një sukses i paimagjinueshëm që ngre lart emrin e Shqipërisë në arenën ushtarake dhe sportive ndërkombëtare.

Ekipi Kombëtar i Mundjes i Forcave të Armatosura, i drejtuar nga nënkolonel Zylfi Shehu dhe i shoqëruar nga shefi i Delegacionit, nënkolonel Gernat Qirici, po përfaqëson denjësisht Shqipërinë në këtë aktivitet prestigjioz botëror. Në garat e tjera pritjet të ngjiten në tapet nënkolonel Bajram Sina, medalist evropian, si dhe studenti Adolf Dema. Në përbërje të ekipit është edhe kolonel Islam Dudaev, medalist olimpiq dhe një nga figurat më të spikatura të sportit të mundjes.

Për të motivuar dhe mbështetur ekipin shqiptar, në këtë ngjarje madhore ka marrë pjesë edhe Atasheu Ushtarak i Shqipërisë në Gjermani, kolonel Arben Zani, i cili shprehu vlerësimin dhe konsideratën e lartë për përfaqësimin e shkëlqyer dhe profesionalizmin e sportistëve tanë.

Ky sukses është fryt i përkushtimit, përgatitjes intensive dhe mbështetjes së pakursyer institucionale, falë vizionit të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjenerallejtënant Arben Kingji, mbështetjes së Ministrit të Mbrojtjes z. Pirro Vengu, si dhe kontributit të vyer të Federatës Shqiptare të Mundjes.





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Njerëzit ikin, ikin...!

Ikja është instinkt. Ikim nga përgjegjësitë, nga dhimbja, nga kujtimet. Ikim nga ajo që nuk duam të përballemi. Por a mund të ikim vërtet nga vetja? Kjo është pyetja që më ndjek si hija ime në çdo hap që bëj, në çdo vend ku shkoj.

Si shumica prej nesh, kam kaluar jetën duke ndërtuar një version të vetes që të tjerët do ta pranonin. Kam qenë bija e prindërve të përkushtuar, nxënësja e përkushtuar, mikja besnike, nëna me kohë të plotë. Por, në të gjithë këtë rrugëtim të mbyllur me etiketa, kisha harruar një pjesë thelbësore: kush isha në të vërtetë.

Në moshën tridhjetë vjeçare, më zuri një boshllëk i thellë. I kisha arritur disa prej qëllimeve që mendoja se do të më sillnin lumturi. Kisha punën, shtëpinë, madje edhe admirimin e të tjerëve. Por çdo mëngjes zgjohesha me ndjenjën se diçka mungonte. Dhe ajo që mungonte nuk ishte diçka jashtë meje. Ishte diçka brenda.

Identiteti dhe Pranimi

Njeriu në thelb është një qenie që kërkon të ikë, nga dhimbja, nga kujtimet, nga e kaluara, nga përgjegjësitë. Por ajo që njeriu nuk arrin dot ta shmangë është vetja e tij. Vetja është gjithnjë aty, në mendime, në ndjenja, në kujtime, në ndërdije.

Është ajo “pasqyrë e brendshme” që nuk thyhet as kur largohemi fizikisht apo emocionalisht.

Ikja si mekanizëm mbrojtës

Ikja, si një akt i zakonshëm njerëzor, një mënyrë për të shmangur vuajtjen ose përballjen me të vërteta të pakëndshme. Kjo mund të ndodhë përmes mohimit, vetë-mashtimit, apo ndërtimit të një imazhi fals për veten.

Vetja si destinacion, jo si arratisje

Vetja nuk është një armik për t’u shmangur, por një realitet për t’u pranuar. Njeriu është shpesh në konflikt me veten, sepse nuk përputhet me idealet që i ka imponuar shoqëria, familja, apo ai vetë. Kjo krijon një ndarje të brendshme që sjell vuajtje.

Çelësi i lumturisë: pranimi dhe kuptimi

Lumturia nuk gjendet jashtë vetes, në pasuri, sukses apo status, por në pranimin e vetes. Kjo do të thotë të pranosh të mirat dhe të këqijat, dritën dhe hijet që na përbëjnë. Nuk është e lehtë, por është thelbësore për qetësinë shpirtërore.

Në botën moderne, shumë njerëz janë në ndjekje të një imazhi ideal për veten, duke mos u ndalur asnjëherë të pyesin nëse ai imazh është i vërteti.

Kush jemi ne pa rolet tona? Pa maskat sociale?

Dhe a kemi guximin ta përqafojmë atë që gjejmë?

Ikja është një nga mënyrat më të zakonshme të reagimit njerëzor përballë dhimbjes apo ndjenjës së zbrazëtisë.

Njerëzit shpesh ikin nga e kaluara, nga dështimet, madje edhe nga suksemi kur ai nuk lidhet me vlerat e tyre të vërteta. Por, ikja nuk është zgjidhje, pasi vetja nuk është një realitet i jashtëm që mund të shmanget, është qenia jonë e brendshme, prezente në çdo mendim, ndjesi apo vendim që marrim.

Të kuptosh dhe pranosh veten nuk do të thotë të jesh pasiv përballë dobësive apo gabimeve, por të zhvillosh një marrëdhënie të ndershme dhe të dashur me atë që je, me dritën dhe hijen që

Udhëtimi drejt vetvetes – Analizë mbi çelësin e lumturisë përmes pranimit personal



bashkëjetojnë brenda secilit prej nesh.

E vërteta e thjeshtë por shpesh e harruar është se, njeriu nuk mund të gjejë qetësi pa ndërtuar më parë paqe me vetveten. Në kohën kur ritmi i jetës na shtyn të fokusohemi tek e jashtmjja, sipërfaqësorja, është thelbësore të ndalemi dhe të kthehemi brenda vetes, jo për të gjetur përsosmërinë, por për të përqaftuar të vërtetën tonë njerëzore.

Të pranosh vetveten: luks, luks i rrallë në kohë krizash të brendshme

Në një botë që mat vlerën e individit me pasqyrime të përzgjedhura në Instagram, me arritje të matshme dhe miratime të jashtme, të pranosh vetveten është bërë një luks. Madje, një luks që pak kanë mundësinë, apo guximin ta përjetojnë. Në thelb, vetëpranimi është një akt rebelimi, kundër pritshmërive të të tjerëve, kundër tryknisë së normave, madje edhe kundër vetë iluzioneve tona.

Është e lehtë të shkruash fjalë si “dua je veten” apo “pranoje kush je”. Por çfarë ndodh kur ajo që je nuk përputhet me atë që të është thënë se duhet të jesh? Çfarë ndodh kur realiteti yt është i mbushur me gabime, me pengje, me mosrealizime?



Pikërisht këtu fillon ajo që pak njerëz e quajnë art, por që është një nga format më të vërteta të tij: të pranosh vetveten përballë realitetit pa filtra, pa justifikime. Arti i vetëpranimit nuk ka të bëjë me vetëkënaqësinë. Nuk ka të bëjë me dorëheqjen nga përmirësimi. Përkundrazi, është fillimi i çdo ndryshimi të qëndrueshëm. Askush nuk mund të ndryshojë vërtet, pa e njohur dhe pranuar më parë atë që është. Sepse nëse i shmangemi të vërtetës së brendshme, çdo përpjekje për përmirësim do të jetë thjesht kamuflim.

Është forcë të thuash: “Po, unë kam dështuar. Po, unë kam dobësitë e mia. Por unë nuk jam më pak njeri për shkak të tyre”. Dhe ky

qëndrim nuk i bën njerëzit të pamotivuar, përkundrazi, i çliron. Shoqëria shqiptare, me gjithë ndryshimet që ka përjetuar, ende vuan nga sindroma e “si dukem në sytë e të tjerëve”. Kjo shpesh shndërrohet në shtypje të individit, në vetëmohim dhe, në raste të rënda, në vetë-urrejtje. Është koha të ndryshojmë narrativën. Është koha të kuptojmë se vetëpranimi nuk është dobësi, por themeli i mirëqenies së brendshme dhe shëndetit mendor.

Të pranosh vetveten në një realitet të ngarkuar me presion dhe paragjykim është një akt emancipues. Është një vendim që i jep njeriut fuqinë për të jetuar me autenticitet. Dhe në kohë si këto, autenticiteti është më i rrallë se kurrë – por edhe më i nevojshëm se kurrë.

Të pranosh vetveten: një e vërtetë që ndihmon për të qëndruar në llogore me sinqeritet

Në një shoqëri ku shpesh na mësojnë të qëndrojmë në “rresht”, të sillemi si pjesë e grupit, të shohim me kujdes perceptimin e të tjerëve, të pranosh vetveten del të jetë një mision më strategjik se sa duket në fillim.

Në përvoja ushtarake, shpesh mësohet se kur ke besim tek vetja edhe me energji të mjegullt dhe forcë të kufizuar merr vendime që ndryshojnë fatin. Ndaj dhe në përditshmëri, kur je në paqe me brendësinë tënde dhe nuk fsheh plagët, ke një armë të vërtetë: autenticitetin.

Ai të sjell paqen, të lidh me komunitetin në mënyrë të sinqertë dhe ajo është baza që mbledh forcën për betejat e mëdha të jetës.

Të kuptosh dhe të pranosh se kush është jo vetëm një akt guximi, por edhe themeli mbi të cilin ndërtohet një jetë e lumtur dhe e plotë.

Ndaj mos harro: Ti nuk je as suksemi yt, as dështimet e tua. Ti je më shumë se çdo emër apo rol. Je njeri, dhe kjo mjafton që të jesh i denjë për dashuri, për falje, për paqe. Mos ik më nga vetja. Kthehu në shtëpi, në veten tënde”.

Tanket, Forca Kryesore Goditëse e Ushtrisë Shqiptare në fund të viteve '80

Në fund të viteve '80, ushtria shqiptare dispononte rreth 1,292 tanke dhe mjete të tjera të blinduara, duke e bërë Shqipërinë një ndër vendet më të fuqishme për nga kapacitetet e blinduara në rajon, raportuar me sipërfaqen e territorit.

Tanket përfaqësonin fuqinë kryesore goditëse tokësore, krahas këmbësorisë, dhe ishin një komponent kyç në doktrinën ushtarake shqiptare të asaj kohe. Ato ishin përqendruar në zonat e ndjeshme për desantim ajror – një formë e re kërcënimi strategjik si në Tiranë, Durrës, Fier, Lushnjë, Korçë, Shkodër dhe Gjirokastrë. Objektivi kryesor ishte bllokimi i menjëhershëm i çdo desanti ajror dhe zbatimi i kundërgoditjeve në rast agresioni nga toka, ajri ose deti.

Njësi Elitare dhe Gatishmëri e Lartë

Njësitë tankiste konsideroheshin njësi elitare të ushtrisë. Gatishmëria dhe organizimi i tyre luftarak ishin në nivel shumë të lartë. Përgatitja e efektivit, mirëmbajtja e teknikës, njohja e terrenit dhe ndërtimi i pozicioneve luftarakë ishin pjesë e një strategjie të gjithanshme.

Kontrollet vjetore nga Drejtoria e Tankeve, Komanda e Brigadave dhe Ministria e Mbrojtjes siguronin standarde të larta. Rreth 30% e tankeve konsideroheshin në gjendje të shkëlqyer teknike e luftarake. Tankeve sovjetike apo kineze u kryheshin shërbimet e plota teknike sipas katalogëve përkatës në Oficinat e Brigadave dhe Uzina e Riparimit të Tankeve në Tiranë, e cila dispononte teknologji për riparime kapitale deri në ndërrimin e motorëve apo armëve.

Stërvitje të Nivelit të Lartë dhe Demonstrime Force

Ushtria zhvilloi një sërë stërvitjesh të rëndësishme me pjesëmarrjen e tankeve. Një nga më të spikaturat ishte stërvitja në Kashar, 1974, ku për herë të parë u eksperimentua përdorimi i tankeve në skenar luftarak. Po ashtu, stërvitja në Sherbenik u zhvillua në kushte të vështira malore, duke testuar aftësinë e manovrimit dhe ndërhyrjes në terrene të vështira.

Një tjetër moment historik ishte kriza e Kosovës, ku njësitë tankiste shqiptare u vendosën në grykën e Morinës, si një sinjal i qartë për Serbinë se ushtria shqiptare ishte e përgatitur dhe e vendosur. Në këtë stërvitje morën pjesë rreth 20 tanke, në një nga demonstrimet më të mëdha të forcës deri atëherë.



Përgatitja e Kuadrove në Armatën e Tankeve

Në funksion të modernizimit dhe profesionalizimit, u ngrit Shkolla e Bashkuar, e cila përgatiste kuadro për të gjitha armët, ndërsa më pas u krijua edhe shkolla e veçantë e tankeve, që formonte komandantë, artiljerë, drejtues tankesh dhe ekuipazhe të specializuara. Brigadat përgatisnin ushtarët, ndërsa shkolla oficerët – një sistem i integruar i përgatitjes ushtarake, i bazuar krejtësisht në kapacitetet vendase.



Trashëgimia e Armatës së Blinduar

Në retrospektivë, forca e blinduar shqiptare në fund të viteve '80 përfaqëson një epokë të lavdishme të organizimit ushtarak shqiptar, ku tanket jo vetëm që simbolizonin fuqinë goditëse, por ishin një instrument real i parandalimit dhe reagimit të menjëhershëm ndaj çdo forme agresioni. Për një vend të vogël si Shqipëria, të arrish një nivel të tillë organizimi, përgatitjeje dhe kapacitetesh teknike në një nga armët më të avancuara të kohës, përbën një arritje madhore me vlera të pakontestueshme historike dhe ushtarake.



Nderimi i Dëshmorëve në Identitetin Kombëtar



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Dëshmori është një figurë unike e kombeve, që nderohet, vlerësohet dhe respektohet nga të gjithë shtetasit e kombeve të tyre. Dëshmori përfaqëson memorien dhe frymëzimin e kombeve, pasi ata kanë rënë në emër të një ideali kombëtar për çështjen e lirisë, pavarësisë, identitetit, interesit kombëtar dhe prosperitetit shoqëror. Çdo komb nderimet dhe vlerësimet e dëshmorëve i bën në përputhje me legjislacionin dhe ka format dhe metodat e veta të nderimit, natyrshëm edhe me veçoritë specifike të tyre.

Nderimi që i bën dëshmorëve kombi francez

Dëshmorët për francezët përfaqësojnë ndjenjën e sakrificës për kombin, mbrojtjen e vlerave republikane dhe ruajtjen e identitetit të lirë të shtetit dhe flamurit trengjyrësh francez. Kombi francez nuk i harron kurrë, por përkujtohen me solemnitet dhe mirënjohje. Vlerësimi i francezëve për dëshmorët e kombit të tyre është thellësisht i rrënjësor në kujtesën historike, identitetin kombëtar dhe kulturën historike dhe qytetare të Francës.




Dëshmorët e Francës në të gjitha epokat e zhvillimit historik janë figura që sakrifkuan jetën për liri, barazi, vëllazëri të kombeve dhe Atdhe. Homazhet zyrtare dhe kombëtare në Francë mbahen çdo datë 11 nëntor, në kujtim të përfundimit të Luftës së Parë Botërore, që në origjinal quhet, “La Journée nationale d’hommage aux morts pour la France” (Dita kombëtare e homazhit për të rënë për Francën). Fakt është se ceremonitë zhvillohen në monumente të dëshmorëve në gjithë Francën, veçanërisht te Harku i Triumfit në Paris, ku ndodhet Flaka e Ushtarit të Panjohur. Ceremonialin e nderon me pjesëmarrje personale edhe Presidenti i Republikës Franceze.

Dëshmorët në Francë janë pjesë e kulturës së memories historike, që nderohen në edukimin shkollor, në muzeumet kombëtare si Muzeu i Luftës së Madhe apo Muzeu i Rezistencës Franceze. Fakt është se Francezët e trajtojnë kujtesën historike si pjesë të “detyrës për të mos harruar” (le devoir de mémoire), ku një nga shprehjet më simbolike dhe më të njohura në rang kombëtar është: “Ils sont morts pour la France”/Ata vdiqën për Francën, që është edhe perifrazimi që përdoret zyrtarisht në përmendoret, bustet, memorialet, pllakatet, dokumentet arkivore shtetërore për të gjithë ata/ato që dhanë jetën për vendin.

Franca bën edhe nderimet individuale, sikurse është dëshmori i njohur Jean Moulin, figura kyçe e Rezistencës gjatë Luftës II Botërore, eshtrat e të cilit prehen në Pantheon në Paris, që është një vend simbolik ku prehen personalitetet më të mëdha të Francës, dhe është forma më e lartë e nderimit për një qytetar francez. Dëshmori francez është lartësuar me mirënjohjen më të madhe edhe në letërsi dhe art, ku figura e dëshmorit është e pranishme në poezitë atdhetare e patriotike, në piktura, në filma, romane, novela që nderojnë trimërinë, heroizmin dhe sakrificën për lirinë dhe vlerat republikane franceze.

Nderimi që i bëjnë amerikanët dëshmorëve të kombit

Amerikanët kanë një vlerësim të thellë dhe solemn për dëshmorët e kombit të tyre, bazuar në ndjenjat e forta patriotike, në krenarinë e kombit të madh dhe respektit të pasqyruar për ata që kanë dhënë jetën për lirinë, demokracinë dhe kombin, brenda apo jashtë vendit për interesat e kombit amerikan si fuqia më e madhe botërore. Nderimi i dëshmorëve bëhet përmes një dite të veçantë që quhet “Memorial Day” (Dita e Përkujtimit) si një festë zyrtare e kombit amerikan që zhvillohet nga viti 1971, çdo vit në fund të majit, për të nderuar ushtarët e rënë në të gjitha luftërat ku ka marrë pjesë SHBA-ja dhe që shoqërohet me ceremoni, parada, vendosje kurorash në varreza dhe heshtje që janë pjesë e nderimeve. Mijëra qytetarë vendosin flamuj amerikanë në varret e dëshmorëve, si në “Arlington National Cemetery”, ku prehen shumë nga heronjtë e kombit (në dy lufta botërore kanë luftuar edhe 8414 shqiptarë në përbërje të ushtrisë amerikane dhe që gjenden në arkivat amerikane. Dëshmorët në SHBA konsiderohen si mbrojtës të parë të kushtetutshmërisë dhe të lirive qytetare. Qeveria dhe ushtria amerikane mbajnë ceremoni të rregullta nderimi, për çdo ushtar që bie në krye të detyrës, flamuri kombëtar u dorëzohet familjarëve me solemnitet me këto fjalë: “On behalf of the President of the United States and a grateful nation...” (në emër të presidentit të SHBA-së dhe një kombi mirënjohës). Disa nga shprehjet amerikane frymëzuese dhe simbolike janë: “All gave some, some gave all.” (Të gjithë dhanë diçka, disa dhanë gjithçka); “Freedom is not free” (Liria nuk është falas); “They died so we could live free” (Ata vdiqën që ne të jetojmë të lirë), fjalë e shprehje frazeologjike që përdoren në ceremoniale përkujtimore, në fjalime presidenciale, në varreza ushtarake etj. Ata që bien në shërbim nderohen me medalje të larta si Medalja e Nderit (Medal of Honor), e cila jepet shpesh pas vdekjes. Amerikanët kanë programe të posaçme për familjet e të rënëve, të quajtura “Gold Star Families”, që janë në vëmendjen e shtetit dhe të shoqërisë përveç nderimeve me medalje të posaçme. Dëshmorët në Amerikë trajtohen denjësisht dhe krenarisht edhe në filma, libra dhe dokumentarë amerikanë, si në: Saving Private Ryan,



Band of Brothers, American Sniper, etj., një kulturë memoristike që ruan gjallë kujtimin dhe sakrificën për brezat e rinj. Është e njohur në SHBA se në ceremonitë perkujtimore ushtarake luhet himni solemn “Taps”, një melodi e heshtur dhe prekëse që simbolizon përshëndetjen e fundit për dëshmorët e rënë në beteja. Dëshmorët në SHBA nderohen e vlerësohen si shtyllat e lirisë kombëtare, me respekt të jashtëzakonshëm nga çdo brez, çdo komunitet dhe çdo institucion amerikan. Ata nuk konsiderohen thjesht të rënë, por heronj të përjetshëm të një kombi që nuk harron asnjëherë.



Nderimi që i bën kombi anglez dëshmorëve

Britanikët, si shumë kombe të tjera me një histori të gjatë të përfshirjes në luftëra, kanë një ndjenjë të thellë respekti dhe nderimi për dëshmorët e tyre dhe ky është një nderim e vlerësim që shfaqet në disa mënyra të veçanta dhe tradicionale: “Remembrance Day” (Dita e Kujtimit). Kështu, më datën 11 nëntor, të çdo viti (në përvjetorin e përfundimit dhe të armëpushimit të Luftës së Parë Botërore), britanikët në të gjithë vendin, ndalojnë për një heshtje në orën 11:00 për të nderuar të rënë në luftëra. Kryeministri dhe familja Mbretërore vendosin kurora me lulëkuqe “poppy” në memorialin e të rënëve në Whitehall, Londër, pranë Cenotaph-it (Memoriali i Dëshmorëve). Simboli i lulëkuqes (poppy) është simbol i sakrificës dhe kujtimit të ushtarëve të vrarë në luftë dhe që përdoret masivisht nga qytetarët, ushtarakët, politikanët, mediat në javët para 11 nëntorit, brenda dhe jashtë vendit, kudo ku shërbejnë bijtë e kombit britanik. Tradita vjen nga poezia “In Flanders Fields” përhapur nga Royal British Legion. Në çdo qytet dhe fshat në Mbretërinë e Bashkuar ndodhen memorialë për të rënë, shpesh me emrat e banorëve që humbën jetën në LIB dhe në LIIB. Këto memoriale nderohen çdo vit, veçanërisht nga brezat e rinj që marrin pjesë në ceremoni të organizuara kryesisht nga brezat e rinj të shkollave britanike. Ushtarakët britanikë të rënë nderohen me funerale shtetërore ose ushtarake, varrosen në varreza të veçanta si ato të “Commonweath War Graves” (varrezat e luftës të Komonuellthit). Kultura angleze ka bërë mjaft libra dhe filma britanikë për sakrificat dhe heroizmin, duke e pasur të shenjtë mirënjohjen kombëtare të brezave. Familjarët e dëshmorëve gëzojnë respekt të veçantë dhe trajtim dinjitoz nga shteti. Edhe britanikët kanë disa shprehje etalon të nderimit si: “Lest we forget” (Që të mos harrojmë kurrë); “They shall grow not old, as we that are left grow old” (ata nuk do të plaken, siç plakemi ne...), nga poezia “For the Fallen” nga Laurence Binyon. Britanikët kanë dëshmorin si figurë të sakrificës sublime, garant i lirisë dhe vlerave kombëtare, vlerësim i rrënjosur thellë në kulturën, arsimin dhe simbolikën publike të vendit.

Italianët nderojnë dëshmorët si unitet vlerash dhe bashkimi kombëtar

Italianët i vlerësojnë dëshmorët me nderim të thellë historik dhe simbolik, duke i konsideruar si simbol i sakrificës, lirisë,



unitetin kombëtar dhe demokracisë, vlerësim që i përket veçanërisht dëshmorëve të Luftës së Dytë Botërore, të Lëvizjes së Rezistencës antifashiste, dhe për ata që dhanë jetën në procesin e bashkimit kombëtar. Italia ka 25 prillin si ditë të Dëshmorëve, ose si festën e lirisë (Festa della Liberazione), si një ditë zyrtare kombëtare të nderimit dhe respektimit të dëshmorëve të rezistencës antifashiste, që sollën çlirimin e Italisë nga nazifashizmi më 1945. Kombi italian kujton luftëtarët partizanë dhe qytetarët që luftuan për lirinë dhe demokracinë, ndërkohë që në çdo qytet zhvillohen ceremoni me përfshirje deri të Presidentit të Republikës dhe nivelin më të lartë të Forcave të Armatosura italiane. Altare della Patria (Altari i Atdheut) në Piazza Venezia është monumenti më i rëndësishëm që simbolizon nderimin për të rënë, ku në qendër është varri i Ushtarit të Panjohur (Il Milite Ignoto) figurë që përfaqëson të gjithë dëshmorët e paidentifikuar. Që prej katër vitesh (prej vitit 1921), truproja e nderit qëndrojnë në vijueshmëri aty dhe çdo vit bëhen zyrtarisht homazhe. Në çdo qytet italian ndodhen pllakate perkujtimore me emra dëshmorësh, në rrugë, shkolla, ndërtesa publike.

Organizata më e madhe që ruan kujtesën e dëshmorëve të rezistencës quhet: ANPI (Associazione Nazionale Partigiani d’Italia). Familjarët e dëshmorëve nderohen si pjesë e historisë kombëtare dhe shpesh përmenden në tekstet shkollore dhe filmat dokumentarë. Simbolika dhe ndjenjat publike për dëshmorët shihen dhe vlerësohen si mbrojtës të vlerave themelore: liri, demokraci dhe barazi. Dëshmorët italianë nderohen edhe me kushtetutën antifashiste italiane, e cila buron nga sakrificat e tyre. Dëshmorët perkujtohen për luftën, për kurajën civile, përfshirë këtu edhe prokurorë, gjyqtarë, gazetarë, oficerë, policë të vrarë nga mafia ose terrorizmi. Ndër thëniet proverbiale popullore italiane më të përdorshme janë: “La libertà è un dovere, prima che un diritto”, sikurse thotë Norberto Bobbio (Liria është një detyrë, përpara se të jetë një e drejtë); “Per non dimenticare” (Që të mos harrojmë).

Në Itali, dëshmorët janë simbol i identitetit kombëtar dhe moral, kontribuues në themelimin e shtetit modern dhe mbrojtjen e idealeve demokratike. Kujtesa e popullit italian është e institucionalizuar, e respektuar dhe pjesë e edukimit të gjerë qytetar. Edhe ne shqiptarët kemi 114 dëshmorë shtetas italianë gjatë luftës antifashiste, por edhe Gjeneral Enrico Tellini është dëshmor i Lidhjes së Kombeve që ra për mbrojtjen e kufijve shqiptarë dhe që është shpallur me titullin e lartë “Dëshmor”, që ra për Shqipërinë.



Nderimi që i bën kombi turk dëshmorëve “Şehit”-ëve

Vlerësimi që Turqia dhe populli turk i bëjnë dëshmorëve të kombit të tyre është jashtëzakonisht i lartë, emocional, i rrënjosur thellë në identitetin kombëtar, historik e fetar të vendit. Kështu në shoqërinë turke, “şehit” (dëshmor) ka një status të shenjtë, të respektuar si hero kombëtar dhe besimtar i rënë për Atdheun dhe Zotin. “Şehit” (dëshmor) vjen nga arabishtja/persishtja dhe do të thotë “dëshmitar” (i besimit), dhe ka kuptim të dyfishtë: kombëtar dhe fetar. Dëshmori është njeri i shenjtë që sakrifikon jetën për vendin, flamurin dhe besimin fetar. Fjala “Şehitler ölmez, vatan bölünmez”/(Dëshmorët nuk vdesin, Atdheu nuk ndahet), ndërsa 18 marsi është dita e Dëshmorëve për nder të fitores së betejës së famshme të Çanalkalesë, “Çanakkale Zaferi ve Şehitleri Anma Günü”, që perkujton betejën e famshme të Çanakalasë, më 1915 gjatë Luftës së Parë Botërore. Në këtë ditë nuk rreshtin ceremonitë shtetërore e ushtarake në të gjithë vendin, me pjesëmarrjen e Presidentit, Forcave të Armatosura

dhe qytetarëve. Nderimi dhe respekti për dëshmorët është masiv në shkolla, ku nxënësit recitojnë poezi për dëshmorët, vizitojnë varrezat ushtarake dhe mësojnë për sakrificën e tyre. Ndërsa 30 gushti është dita e “Zafer Günü”/dita e fitores që perkujtohet me madhësi. Në Turqi ndodhen me dhjetëra varreza dëshmorësh (şehitlik), ku prehen ushtarë dhe qytetarë të vrarë në luftëra apo sulme terroriste. Vetëm në kryeqytetin Ankara ka dy varreza të dëshmorëve të kombit turk, por monumenti i dëshmorëve të Çanakalasë në Gallipoli është një nga vendet më të vizituara në botë, një simbol i krenarisë kombëtare dhe i fitores së madhe të vitit 1915 ndaj disa ushtrive njëherazi. Në Gallipoli janë varrezat e shtatë ushtrive si dhe qindra shehitë të kombit shqiptar të rënë në luftë për mbrojtjen e Çanakalasë me rreth 26 mijë të rënë. Në qytete si Ankaraja e Stambolli si dhe qytete të tjera të Turqisë ndodhen monumente madhështore, ku zhvillohen homazhe. Në Izmir është një monument që quhet “İlk Kurşun”/plumbi i parë, që i kushtohet luftës së madhe patriotike që e pritën grekun me pushkë dhe triumfuan mbi të. Respekti për familjet e dëshmorëve në Turqi është i jashtëzakonshëm, pasi u jepen familjeve të tyre nga shteti përfitime ekonomike, banesa, punësime publike dhe kujdes i veçantë shëndetësor e social. Gjatë fjalimeve politike e ushtarake, përmendja e nënave të dëshmorëve (şehit anneleri) përcillet me emocione të mëdha dhe duartrokitje. Nënë dëshmori është një krenari kombëtare e jashtëzakonshme. Edhe në xhami luten shpesh për shpirtrat e dëshmorëve, duke i konsideruar si të pavdekshëm në sytë e Zotit. Sipas traditës islame, “një dëshmor hyn në xhenet pa gjykim”, gjë që e rrit ndjenjën e nderimit dhe krenarisë. Në media dhe arsimin publik, dëshmorët përshkruhen si modele të larta morali dhe sakrifice, shpesh me portrete dhe histori të tyre. Janë me dhjetëra thëniet për dëshmorët: “Vatan için canını veren her kişi şehittir” (kushdo që jep jetën për atdhe, është dëshmor); “Bayrakları bayrak yapan üstündeki kandır; Toprak eğer uğrunda ölen varsa vatandır.” – Mithat Cemal Kuntay (Ajo që e bën flamurin flamur është gjaku që është derdhur mbi të; toka bëhet atdhe vetëm kur dikush ka vdekur për të). Turqia e konsideron dëshmorin si themel të lirisë, nderit dhe unitetit kombëtar, ku nderimi për dëshmorët është institucional, kulturor, fetar dhe emocional, si dhe përfaqëson një nga shtyllat më të forta të identitetit dhe moralit kombëtar turk.



Po vlerësimi për dëshmorët nga kombi shqiptar?

Kombi shqiptar i ndarë, copëtuar dhe sakatuar shekujve është një komb heroik, që i ka mbijetuar dallgëve të historisë dhe që vlerësohen në rreth 60 mijë të rënë në dy shekujt e fundit, edhe pse gjaku i dëshmorëve nuk mund të përllogaritet me numra. Nderimi i dëshmorëve ka spikatur në gjysmëshekullin e dytë të shekullit XX. Sot në Shqipëri ka 35 varreza dëshmorësh me eshtrat e dëshmorëve të LANÇ-it. Kultura shqiptare e kujtesës për dëshmorët e Shqipërisë përmblihet në disa qindra memorialë, lapidarë, buste, pllakata, filma, romane, gazeta, revista, shkrime në rrjetet sociale me mijëra, pa përmendur këtu luftën çlirimtare të Kosovës (UÇK). Shprehja “kush ka vdekur për Atdhenë nuk ka vdekur por ka lerë” është mjaft sinjifikative. Perkujtimi i dëshmorëve bëhet më datën 5 maj si dita e dëshmorëve por edhe më datën 29 nëntor që është dita e çlirimit të Shqipërisë. Në Shqipëri ka vetëm një libër zyrtar për dëshmorët “Dëshmorët e Atdheut”, të publikuar me rastin e 100 vjetorit të krijimit të shtetit shqiptar nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes përgatitur në AQFA. Megjithatë sado të bëhet për dëshmorët gjithmonë është shumë pak se gjaku i derdhur për Atdheun nuk ka çmim, nuk ka asnjë parametër e mekanizëm që mund ta vlerësojë sa e si duhet. Përjetësia e dëshmorëve është kujtesë e përhershme për lirinë e kombit që shekujve e ka larë përmes gjakut rrugën e zhvillimit dhe të përparimit, rrugëtimin e mbijetesës përmes gjakut të derdhur në themelet e lirisë së kombit.



Përgatiti: SAKIP CAMI

- *Gazetari ushtarak që përcolli direkt kronikat e luftimeve në provokacionet e gushtit 1949.*
- *Gazetari që ia tha të vërtetat në sy Enver Hoxhës.*
- *Poeti që vuajti në burg së bashku me poetët: Jorgo Bllaci dhe Pano Taçi.*

Jetëshkrimi: Ushtarak, gazetar dhe shkrimtar, i dënuar me 24 vjet heqje lirie nga diktatura komuniste. 1945-1949 oficer në Korçë. Gazetar te gazeta “Luftëtari” 1949-1956. Sekretar Kolegjiumi te Revista “Në shërbim të Popullit” 1956.

Lindur më 29 janar 1929 në fshatin Laçej, Çidhën, Dibër. Ka mbaruar Internatin e Kastriotit të Dibrës me mësuesin e gjuhës dhe të letërsisë shqipe, shkrimtarin partizan Qamil Guranjaku. Ishte ai që zbuloi talentin letrar të Bajramit, ishte ai që e radhiti Bajramin në rreshtat partizane, që në moshën 15 vjeç.

Në Konferencën e Tiranës në vitin 1956, pas diskutimeve kur u erdhi radha pyetjeve, u ngrit ish-partizani, ushtaraku dhe gazetari Bajram Hyseni dhe i drejtoi dy pyetje Enver Hoxhës: “A është e drejtë që të akuzohet familja e Murat Kaloshit për vënie në shërbim të Ballit Kombëtar dhe që i paska sjellë dëme të mëdha luftës në Dibër? Si shpjegohet që të akuzohet për këtë gjë Murat Kaloshi, kur ai në atë kohë nuk ka qenë fare në Shqipëri pasi ka qenë larguar që në 1939-ën së bashku me Mbretin Zog, e nuk është kthyer më kurrë?”.

Duke qenë një nga familjet më të njohura të asaj zone, babanë e Bajramit, Hysen Kovaçin, për 14-vjet me radhë fshati e kishte zgjedhur si kryeplak.

Nga viti 1943 së bashku me Zenel Zhukën e Elmaz Përgjegjën, formuan organizatën e Rinisë Antifashiste të rrethit të Dibrës.

Më pas u inkuadrua në Batalionin partizan Dibër-Martanesh që komandohej nga Qemal Beluli, me të cilin mori pjesë në luftimet për çlirimin e Tiranës.

Më 2 shkurtin e vitit 1945, u pranua si anëtar i Partisë Komuniste dhe u caktua si oficer në repartin e Ndërlidhjes, ku kryente detyrën e Përgjegjësit të Rinisë.

Bajrami shërbeu si ushtarak dhe si korrespondent shtypi nga fronti i luftimeve gjatë Provokacioneve të Gushtit 1949.

Pasi punoi për disa kohë në repartin e ndërlidhjes, Bajram Hysenin e transferuan për në Divizionin e Korçës, duke e caktuar si radist personal të Beqir Ballukut, komandantit të atij divizioni.

Filloi të shkruante poezi, tregime e reportazhe, të cilat i dërgonte me postë dhe me korrier ushtarak nga Korça dhe i botonte në gazetën “Luftëtari”, ku kryeredaktor ishte ish-mësuesi i tij, Qamil Guranjaku.

Shkrimet e Bajramit u pritën mirë dhe që nga ajo kohë ai u bë korrespondent i rregullt i asaj gazete.

Aty nga vera e vitit 1949, kur filluan Provokacionet e Gushtit në kufirin me Greqinë, Bajrami u dërgua në frontin e luftës, ku përveç shërbimit që bënte si radist, mbante shënime në bllok për atë çfarë ndodhte aty.

Ato shënime me anë të korrierit i dërgonte në Tiranë dhe ato botoheshin jo vetëm nga gazeta “Luftëtari”, por edhe nga “Zëri i Popullit”, “Bashkimi” etj.

Kështu ai ishte gazetari i vetëm që përcolli në shtyp të gjitha ngjarjet e betejat që u zhvilluan ndërmjet forcave të ushtrisë sonë dhe atyre greke.

Në vitin 1952 transferohet në Tiranë dhe emërohet në redaksinë e gazetës “Luftëtari”, ku punoi deri në vitin 1956, kur ndodhën ngjarjet e Konferencës së Partisë së Tiranës, ku ai mori pjesë si gazetar. Në atë kohë Bajrami kishte botuar shumë libra, ndër ta edhe novelën e famshme “Sllavjanka”, e cila u botua në 14 gjuhë të botës. Kjo novelë u quajt nga specialistët e partisë në letërsi dhe në ushtri si nostalgji për vajzat ruse dhe për Rusinë, me të cilën Partia e Punës së Shqipërisë dhe Enver Hoxha tashmë ishin ndarë përfundimisht.

Në një mbledhje sqaruese për Konferencën e Tiranës, në Shkollën e Lartë të Partisë në Tiranë, ku morrte pjesë edhe Enver Hoxha me Rita Markon, kur u erdhi radha e pyetjeve, u ngrit dhe i tha Enver Hoxhës:

- A është e drejtë që të akuzohet familja e Murat Kaloshit, për vënie në shërbim të Ballit Kombëtar dhe që i paska sjellë dëme të mëdha luftës në Dibër?

